



Datë: 19.06.2025
Numër Protokolli: 4187/2025

A.nr.1107/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1107/2025, të datës 10.06.2025, të parashtruar nga ankuesja, Sh.M., kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1107/2025, e datës 10.06.2025, e parashtruar nga ankuesja, Sh.M.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 10.06.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimeve për refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017569, për pozitën “*Zyrtar i Gjendjes Civile 2*”, si dhe procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017571, për pozitën “*Zyrtar për Shërbim me Qytetarë*”, të shpallur nga Komuna e Gjilanit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e parakohshme, **sepse**:

Nga analizimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Gjilanit, më datë 07.04.2025, ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00017569, për Grupin e Shkencave Shoqërore, për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile 2, me klasë të pozitës profesional 2, për tri (3) vende pune, në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, ndërsa, po ashtu më datë 07.04.2025, ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00017571, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën Zyrtar për Shërbim me Qytetarë, me klasë të pozitës profesional 2, për dy (2) vende pune, në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, të hapura me aplikim më datën 08.04.2025 deri me datën 07.05.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se në konkursat përkatëse të punësimit ka aplikuar edhe ankuesja e cila sipas Njoftimeve të datës 22.05.2025 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, të njëjtës i janë refuzuar aplikacionet me arsyetimin se nuk e ba bashkangjitur përvojën e punës së kërkuar profesionale së paku dy vite përvojë pune profesionale konform kualifikimit.

Ankuesja, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke i kundërshtuar njoftimet për refuzimin e aplikacioneve, me pretendimin ankimor se refuzimi i aplikacioneve është, i kundërligjshëm, pasi që të dy konkurset bien ndesh me ligjin material, pasi që në konkurs kërkohet përvoja së paku një vit përvojë pune, e që bie ndesh me vendimet për refuzimin e aplikacionit. Kërkon nga Këshilli që të aprovohet ankesa si e bazuar.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: 12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative*, si dhe nenin 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve*. Andaj, referuar këtij përcaktimi ligjor si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja më datë 1107/2025, është e parakohshme, ngase, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesja ka parashtruar ankesë ndaj njoftimit për refuzim të aplikacioneve, si veprim procedural në fazën e verifikimit paraprak, kështu që, duke qenë se ankesa është parashtruar ende pa u shpallur njoftimi për rezultatin përfundimtar për procedurën përkatëse të rekrutimit, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ankesa A.nr.1107/2025 është e parakohshme.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë e ankesës si parakohshme, nuk mohon të drejtën e ankueses, që të kundërshtoj Njoftimet për refuzimin e aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Theksuar si me lart, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1107/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, Sh.M.;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.